



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Njoftim publik

Drejtoria e Urbanizmit – Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër **05-015/02-116250/24 dt.03.09.2024**, në emër të investitorit **BP Home Village LLC**, përmes së cilës kërkohet të emërtohen rrugët dhe të caktohet adresa për ndërtimin e kompleksit **“Qershia Village”** m e 59 shtëpi banimit individual, në lagjen Çagllavicë.


Agjencia Kadastrale e Kosovës i ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., Neni 7, pika 1, pika 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, i ka dhënë këtyre rrugëve të reja një kod të veçantë (11432, 11434, 11435, 11436 dhe 11439) si dhe ka bërë propozimin për emërtimin e këtyre rrugëve.

Emri i propozuar: **“EMIL LËGARD”** – Bibliograf Francez, **“LENIA”** – Toponim mal në Shqipëri, **“LUZINA”** - Krahinë në rrethin e Dibrës, **“MARTIN LUTER KING”** - Ishte një ministër baptist amerikan, aktivist dhe filozof politik, **“MARK BASAITI”** - Piktur Venecian i Rilindjes së hershme.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 17.10.2024 deri më 25.10.2024, në E-mail adresën: urbanizmpriштine@rks-gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: